

Arka ngrirëse

Ju falënderjmë për besimin që keni treguar duke blerë aparatit tonë.


Ju dëshirojmë shumë kënaqësi te përdorimi.

Aparati është i dedikuar vetëm për përdorim në amvisëri.

Arka ngrirëse është e dedikuar për përdorim në amvisëri për ngirjen e artikujve ushqimorë të freskët dhe ruajtjen e tyre (deri në një vit, varësisht nga lloji i artikujve ushqimor).

Temperatura në brendësi është -18°C ose më e ulët.

Para përdorimit të parë	56
Këshilla për kursim të energjisë elektrike	57
Vërejtje të rëndësishme	58
Vendosja dhe aderimi.....	59
Komandimi i aparatit	61
Shkrirja dhe pastrimi i aparatit	65
Evitimi i pengesave	66

- Fëmijët e moshës tetë vjeçare e më shumë dhe personat me kapacitet të dobët fizik, sensorik dhe mental ose me njohuri dhe eksperiencë të mangshme, mund të përdorin aparatit në fjalë nën mbikqyrje adekuate ose në qoftë se kanë marrë udhëzime të përshtatshme sa i takon përdorimit të aparatit dhe në qoftë se i kuptojnë rreziqet lidhur me përdorimin e aparatit. Nuk lejohet që fëmijët të pastrojnë aparatit dhe të ndër marrin veprime për mirëmbajtje në të, pa mbikqyrje adekuate.
- Para kyçjes së aparatit, nevojitet që me saktësi të lexoni udhëzimet për përdorim të cilat e përshkruajnë aparatit si dhe përdorimin e tij të rregullt dhe të sigurtë. Udhëzimet janë të dedikuara llojeve/modeleve të ndryshme të aparateve, prandaj mund të jenë të përshkruara edhe rregullimet dhe pajimet të cilat aparatit i juaj nuk i përban.
- Evitoheni ambalazhin e dedikuar për ruajtjen e aparatit, repektivisht pjesëve tjera gjatë transportimit.
- Nën kapakun e arkës janë të vënduar distancuesit, e këto mbrojnë guarnicionin e kapakut prej dëmtimeve të transportit.
- Para aderimit në rrjetën elektrike, le të qëndrojë aparatit në pozicion vertikal (qirithi) së paku 2 orë. Kështu ulni mundësinë e funksionimit jo të rregullt për shkak të ndikimit të transportit në sistem të ftohjes.
- Para kyçjes së parë, pastroni brendësinë e aparatit me ujë të ngrohtë, të cilit i keni shtuar ca uthull.
- Aderimi në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të realizohet në bazë të rregullave dhe standardeve në fuqi.
- Nuk lejohet përdorimi i aparatit në jashtësi si dhe jo nën ndikimin e shiut.
- Patjetër shkyçni aparatit nga rrjeta elektrike (nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza) para pastrimit, ndërrimit të llambës dhe ndreqjes. Ndreqjen e aparatit mund të kryej vetëm profesionisti.
- Nëqoftëse kabllot kyçëse është e dëmtuar, atëherë ta ndërrojë serviseri ose personi i aftësuar profesionist.
- Nëqoftëse gjatë kohë nuk do të përdorni aparatit, shkyçni aparatit me rrotullimin e pullës së termostatit në pozicion  (përshkruar në kaptinën Komandimi i aparatit me rregullim mekanik – Kyçja/Shkyçja e aparatit) dhe ndërpreni furnizimin me energji elektrike në aparat. Aparatit e zbrazni, shkrini, pastroni dhe e leni kapakun gjysëm të hapur.
- Për ambalazhim përdorim materiale të pranueshme për rrethin, të cilat pa rrezik për rrethin mund të ripërpunohen, deponohen ose të zhduken.
- Le të mos loz fëmia me aparatit.

⚠ Aparati përmban kondensator, i cili rrezaton ngrohtësi në ambient. Ai është i instaluar në anën e pasme ose menjëherë nën teneqenë e anës frontale dhe të pasme të aparatit. Te funksionimi normal, kohë pas kohe këto sipërfaqe janë të ngrohta, kurse te temperaturat e larta të ambientit këto sipërfaqe mund të jenë edhe shumë të nxehta (deri më 55°C). Kjo është dukuri normale që rrjedh nga funksioni i aparatit dhe është i përshkruar në shtojcën e udhëzimeve.

⚠ Hapësirat për ajrosje gjithmonë të jenë të pastërta dhe qasëse.

⚠ Mos përdorni te shkrirja ndihmesa mekanike ose metoda tjera përveç të atyre që i rekomandon prodhuesi. Jeni të kujdesshëm që të mos shponi murinë e jashtme të parë ose të pasme ose cilëndo sipërfaqe të brendëshme të arkës. Në këte mënyrë mund të parandaloni dëmtimet e sitemit për ftohje.

- Te modeli që përmban kondensator të instaluar në murinë e fundit të aparatit, jeni të kujdesshëm që te pastrimi të mos e dëmtoni.

⚠ Te pozicionimi, pastrimi dhe evitimi i aparatit jeni të kujdesshëm që të mos dëmtoni izolimin, respektivisht pjesët e sitemit të ftohjes. Me këte parandaloni edhe ndotjen e mjedisit.

⚠ Mos përdorni mbaresa elektrike në brendësi të aparatit, përveç të atyre të cilat i lejon prodhuesi i aparatit ftohës ngrirës.

Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2002/96/EG (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Këshilla për kursim të energjisë elektrike

- Pozicionojeni aparatit siç është përshkruar në udhëzime.
- Mos hapni kapakun e aparatit më shpesh se sa nevojitet.
- Te modeli me kondensator të instaluar në murinë e fundit të aparatit, kohë pas kohe kontrolloni se a është qarkullimi i ajrit i papengueshëm dhe se kondensatori të jetë gjithmonë i pastruar (shiqo kaptinën Evitimi i pengesave)
- Guarnicionin e dëmtuar ose jo puthitës ndërrojeni sa më parë.
- Para futjes së artikujve ushqimorë, ata ftohni në temperaturën e dhomës.
- Rekomadojmë që të shkrini dhe pastroni aparatit 1 deri më 2 herë në vit.
- Mos hapni kapakun më shpesh se sa nevojitet, sepse, hapja e shpeshtë shkakton rritjen e temperaturës në arkë, shkaktim i tepërt i acarit dhe me këte shpenzim më të lartë të energjisë elektrike.
- Mos mbani arkën gjatë kohë të hapur, kjo është posaçërisht e rëndësishme te koha e ngrohtë dhe e lagshtë.
- Çdo mosmarrje në konsiderim të udhëzimeve të përshkruara në kaptinat Vendosja dhe Kursimi me energji elektrike mund të shkaktojë shpenzim më të lartë të energjisë.
- Te modeli i aparatit, i cili ka të instaluar kondensator në izolim, siguroni qarkullimin e papengueshëm të ajrit edhe në faqen frontale të aparatit.

Vërejtje të rëndësishme

- Nëqoftëse aparati i blerë ka zavendësuar aparatin e vjetër me mbyllëse e cila nuk hapet nga brenda, (bravë, mbyllëse) ate nevojitet të çaftësoni. Kështu do të ulni rrezikun për fëmijt dhe do t'i ruani nga zabullimi eventual.
- Kyçni me rregullsi aparatin në rrjetën elektrike
- Gjatë funksionimit të aparatit mos prekni sipërfaqet ftohëse, apostafat jo me dorët e lagështa, sepse, lëkura mund të ngjitet në sipërfaqet e ftohta.
- Mos ngrini pijet në shishe, veçanërisht jo ata që shkumohen, siç janë uji mineral, vera shkumuese, birra, cola etj., sepse lënda fluide te ngrirja zgjerohet dhe qelqi mund të plasë.
- Mos hani artikujt ushqimorë të ngrirë (buka, pemët, perimet), sepse mund të shkaktohet morth.
- Nëqoftëse janë të dyshueshme ngjyra ose shija e ndonjë artikulli ushqimorë, ate hudhni, sepse mund të jetë e rrezikshme për ushqim.
- Mos shkrini aparatin me mbaresat elektrike (terësi i flokëve dhe të ngj.) dhe mos evitoni ngricën respektivisht akullin me mjete të prehta, por vetëm me ndihmesat e bashkangjitura.
- Aparati përmban lëndë ftohëse dhe vaj, prandaj, aparatin e dëmtuar evitoheni në përputhje me kërkesat mbrojtëse ekologjike.
- Pillaka kryesore me shënimet elementare gjendet në brendësi ose në anën e pasme të aparatit. Në rast se etiketa me shkrimin është në gjuhë që nuk ju përshtatet, ate e këmbeni me të bashkangjiturën.
- Aparatin e harxhuar menjëherë nxjerrni nga përdorimi.
- Duke u kujdesur për ambientin e shëndoshë, kujdeseni që të mos dëmtoni pjesët e sistemit për ftohje, ata gjenden në faqen e pasme të aparatit, në hapësirën e kompresorit ose në izolim. Deri te dëmtimi i sistemit për ftohje mund të vijë edhe nëqoftëse e shponi murinë e jashtme ose të brendëshme.
- Pajisja e brendëshme e aparatit mund të ndryshojë në bazë të modelit të aparatit.

Koha e ruajtjes në rast të prishjes ose dështimit të energjisë elektrike

- Në rast të prishjes ose dështimit të energjisë elektrike mos hapni ngrirësin. Nëqoftëse ndërprerja zgjat më shumë se dy ditë, zbrazni ngrirësin, artikujt ushqimorë harxhoni respektivisht kujdeseni që të mbesin të ngjira.

Vendosja dhe aderimi

Zgjedhja e hapësirës

- Aparatin vendojeni në hapësirë të thatë dhe rregullisht të ajrosur. Lagështia relative deri në temperaturën 25°C nuk guxon të jetë më shumë se 70%, kurse mbi 25°C deri në 75%. Temperatura e lejuar e rrethit për funksionimin e rregullt të aparatit është e kushtëzuar me realizimin e aparatit (klasën), e kjo është e cekur në etiketën e shënimeve të aparatit.

Klasa	Temperatura e rrethit
SN (subnormale)	prej +10°C deri +32°C
N (normale)	prej +16°C deri +32°C
ST (subtropike)	prej +16°C deri +38°C
T (tropike)	prej +16°C deri +43°C

- Bodrumi i lagshtë nuk është i përshtatshëm për arkën ngrirëse, gjithashtu jo ballkoni respektivisht hapësira ku arka është e vurë nën ndikimin direkt të rrezeve të diellit. Nevojitet të qëndrojnë në dysheme të thatë dhe mjaft të fortë, që të qëndrojnë horizontalisht dhe stabile edhe kur është e plotë.
- Aparati nuk është i dedikuar për instalim. Rreth arkës ngrirëse siguroni 2-3 cm hapësirë për qarkullim të papengueshëm të ajrit.
- Diferencën nga muria në anën e pasme e cakton mentesheja.
- Aparati përmban kondensator, i cili lëshon ngrohje në rreth. Ai është i instaluar në faqen e fundit ose direkt nën teneqenë e murisë së pasme ose frontale të aparatit. Për funksionimin e rregullt siguroni ftohje të mirë për këto sipërfaqe dhe mos i mbuloni me gjësende.


Aderimi në rrjetën elektrike

Kjo pajisje mund të veprojë në një mjedis me temperaturë minimale prej -15 °C, nëse udhëzimet në kapitullin »Zgjedhja e hapësirës« janë ndjekur në mënyrë rigoroze.

Aparatin e aderoni në rrjetën elektrike me kablo aderuese. Priza në muri nevojitet të përmbaj kontakt tokëzues (prizë mbrojtëse). Tensioni elementar i paraparë dhe frekuenca janë të cekura në pllakën kryesore të shënimeve të aparatit. Aderimi në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të jenë të kryer në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi. Aparati rreziston në oscilime kohëshkurte në tension, por më së shumti -6 deri +6 %.

Qarkullimi i ajrit rreth aparatit


- Aparati nuk është i dedikuar për instalim. Rreth arkës ngrirëse siguroni 2-3 cm hapësirë për qarkullim të papengueshëm të ajrit.
- Te modelet të cilët në murin e pasme kanë të instaluar kondensator të jashtëm, siguroni largësi nga muria prej 70 mm (shiqo fotosin).




- Te modelet të cilët kanë të instaluar kondensator drejtpërdrejt nën teneqenë e murisë së pasme të aparatit, largësinë nga muria e cakton mentesheja.

Komandimi i aparatit

NJËSIA E KOMANDIMIT I




NJËSIA E KOMANDIMIT II




- A** Pulla e rregullimit të temperaturës, kyçje, shkycje e aparatit dhe kyçje e ngrirjes intensive
- B** Llambëza ndriçon: funksionon rregullimi Ngrirja intensive
- C** Llambëza ndriçon: aparati është nën tension
- D** Llambëza ndriçon/rreh: sinjali i temperaturës tej të lartë

Kyçja e aparatit



Pullën e termostait **A** rrotulloni në drejtim të akrepit të orës kah pjesa më e trashë e signacionit.



Njësia e komandimit I:


Te kyçja e parë ndriçon llambëza **D** dhe shuhet vetë, pasi që ngrirësi ftohet mjaftueshëm, që nuk ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë.


Njësia e komandimit II:


Te kyçja e parë, aparati ka vonesë 24 orëshe të alarmit të temperaturës, pasi që aparati akoma nuk arrin temperaturën e nevojshme.

Kështu parandalohet funksionimi i panevojshëm i alarmit.

Shkyçja e aparatit




Pullën **A** rrotullojeni prapas ashtu, që pozicioni i shigjetës të jetë te shenja  (aparati është akoma nën tension elektrik).



Llambëza **C** akoma ndriçon.

Përzgjedhja e temperaturës në aparat




- Rregullimi i preferuar i pullës së termostatit **A** është në mes të pjesës më të hollë dhe më të trashë të signacionit.
- Në ndryshimin e temperaturës në aparat ndikon temperatura e rrethit dhe shpeshtësia e hapjes së kapakut.

Adaptoni kësaj në mënyrë përkatëse rregullimin e pullës së termostatit.
Pozicionet kah pjesa më e trashë e signacionit domethënë temperaturën më të ulët në aparat (më ftohtë), kurse pozicionet kah pjesa më e hollë e signacionit temperaturë më të lartë (më ngrohtë).



Llambëza **D** ndriçon / rreh, kur brendësia e ngrirësit tejetngrohet dhe shuhet vetë, kur ngrirësi ftohet mjaftueshëm, që nuk ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë (shiqo kaptinën Evitimi i pengesave).

Kurdisja e aparatit



Kyçni aparatin dhe pullën e termostatit e rrotulloni në funksionim intensiv *.

Njësia e komandimit I:

Ndriçojnë të tre llambëzat (B,C,D).

Njësia e komandimit II:

Ndriçojnë llambëzat B dhe C.

Artikujt ushqimorë të freskët futni në aparat ca orë pasi që shuhet llambëza D.


Ngrirja e artikujve ushqimorë të freskët

Përdorimi i rregullt i aparatit, amballazhimi adekuat i artikujve ushqimorë, mirëmbajtja e temperaturës së përshtatshme dhe marrja në konsiderim e higjenës së artikujve ushqimorë, vendimtarisht ndikon në cilësinë e ngrirjes së artikujve ushqimorë të freskët, respektivisht ruajtjen e tyre.

Për ngrirje përzgjedhni artikuj ushqimorë të cilët janë të përshtatshëm dhe i bajnë mirë temperaturat e ulëta.


- Përdorni artikuj ushqimorë me cilësi më të lartë.
- Ngrini vetëm pemë dhe perime krejtësisht të freskëta.
- Për ata përdorni amballazh adekuat dhe me rregullsi i amballazhoni.
- Amballazhi nuk guxon të lëshojë ajrin dhe lagështinë, kjo shkakton terjen e përbërjes dhe humbje në vitamina.
- Folitë dhe qeskat nevojitet të jenë të buta dhe fleksibile, që të puthiten ngushtë me përbërjen.
- Enët për ngrirje nevojitet të mbyllën mirë.
- Para së gjithash është e rëndësishme, që artikujt ushqimorë t'i ngrijmë në kohë sa më të shkurtër. Prandaj rekomandojmë që mbështjellëset të mos jenë shumë të mëdha dhe se artikujt ushqimorë para futjes të ftohen.

Procesi i ngrirjes



- 24 orë para ngrirjes së artikujve ushqimorë të freskët e aktivizoni ngrirjen intensive:
 - rrotullojeni pullën A në pozicion * (ndriçon llambëza B),
 - futni artikujt ushqimorë të freskët në hapësirën për ngrirje.

Paraprakisht se të futni artikujt ushqimorë, ata ftohni në temperaturën e dhomës. Artikujt ushqimorë të freskët nuk guxojnë të preken me qeskat e ngrira.



- Sasia maksimale e artikujve ushqimorë të freskët të cilën mund menjëherë të futni në aparat është e cekur në pllakën me të dhënat elementare të aparatit.
- Nëqoftëse sasia është më e madhe, cilësia e ngrirjes do të jetë më e dobët, por dobësohet edhe cilësia e artikujve ushqimorë që të ngrirë.
- Te sasia e madhe e artikujve ushqimorë të freskët, procesin e ngrirjes përsëritni.
- Për ngrirjen e sasive më të vogla (1-2 kg) rregullimi i ngrirjes intensive nuk nevojitet.
- Pas përfundimit të ngrirjes, rrotullojeni pullën **A** prapas në rregullimin e dëshiruar, megjithatë që llambëza **B** nuk ndriçon (kjo dmth që është arritë temperatura mjaft e ulët).
- Në rast se rregullimin nuk e shkyçni me dorë, ai shkyçet automatikisht pas përafërsisht dy dytëve. Temperatura e pjesës për ngrirje rikthehet në vlerën e rregulluar më së fundi (pozicioni i pullës mbetet në *).

Ruajtja e artikujve ushqimorë të ngrirë

Koha e ruajtjes së artikujve ushqimorë në gjendjen e ngrirë varet nga përmbajtja veçanti e artikujve ushqimorë, kualitetit, vjetërsisë dhe të ngj. Përmbajtja e yndyrave posaçërisht shkurton afatin e ruajtjes. Kështu p.sh. mishin e payndyrshëm e ruani në ngrirës 12 muaj, kurse atë me yndyrë vetëm 4-6 muaj. Artikujt ushqimorë i ruani në enët e mbyllura ose përkatësisht të ambalazuara.

Artikujt ushqimorë të ngrirë në mënyrë industriale

Në ambalazh të artikujve ushqimorë të ngrirë në mënyrë industriale janë të shënuara koha dhe temperatura e ruajtjes.

- Përzgjedhni vetëm artikuj ushqimorë të ambalazhuar mirë.
- Mbroni artikujt ushqimorë nga shkrirja, sepse rritja e temperaturës së artikujve ushqimorë të ngrirë shkurton kohën e ruajtjes.

Artikujt ushqimor të gjysëm shkrira ose krejtësisht të shkrira sa më parë të përdoren.

Shkrirja e pjesëshme ul vlerën ushqimore të artikujve ushqimorë, posaçërisht të pemëve, perimeve dhe ushqimit të përgatitur.

Afati i përafërsishëm i ruajtjes së artikujve ushqimorë të ngrirë

Artikulli ushqimor	Afati i ruajtjes (në muaj)											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Perimet								+	+	+		
Pemët										+	+	+
Buka, ëmbëlsira			+									
Qumështi			+									
Gjellat e gatshme			+									
Mishi: i lopës										+	+	+
i viçit								+	+	+		
i dërrit				+	+	+						
shpendia								+	+	+		
mishi i egër						+	+	+				
i prerë				+								
Suxhuk i tymosur	+											
Peshku: i lehtë			+									
i yndyrshëm	+											
Imtësitë		+										

Shkrija dhe pastrimi i aparatit

Shkrija e aparatit

- Aparatin e shkrihi 1 deri në 2 herë në vit, respektivisht më shpesh te hapja e shpeshtë. Në disa vende mund të tubohet shtresë më e trashë e ngricës – akullit, para së gjithash rreth valvulës për ajrosje. Kjo është dukuri e zakonshme, që shkaktohet për shkak të hyrjes së ajrit të lagështë. Ngricën mund të heqni kohë pas kohe me rendernë e bashkangjitur.
- Përafërsisht 24 orë para shkrijës rrotullojeni pullën (A) në pozicion të funksionimit intensiv * (ndriçon llambëza B), që të ftohen artikujt ushqimorë më shumë.
- Nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.
- Zbrazni aparatit dhe artikujt ushqimorë mbroni nga shkrija.


Mënyra më e shpejtë e shkrijës së ngricës

Me rendernë e bashkangjitur kruani ngricën nga sipërfaqet e ftohjes dhe me reckë të butë e evitoni nga arka, para se të shkrihet.

Evitimi i ngricës me shkrije

Nëqoftëse ngrica është shumë e trashë për kuarje, atë nevojitet pjesërisht të shkrihi.

- Evitoni taponë (1) në anën e parë të ngrirësit.
- Në birë futni gypzën e bashkangjitur (2), kurse nën te vëndoni enën për tubimin e ujit të shkrire.
- Evitoni taponë (3) në fund të ngrirësit.



- Lejeni kapakun e hapur, që të përshpejtësoni shkrijen. Me reckë fshijeni sipërfaqet e brendshme, vendoni që të dy tapotë, gypëzën ruani për përdorim të mëvonshëm.
- Te shkrijra, mos përdorni sprucues për shkrijje, sepse ata mund të shkrijnë pjesët nga plastika, respektivisht dëmtojnë shëndetin.

Pastrimi i aparatit

Para pastrimit nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza!

Mos përdorni lëndë pastruese të vrazhdëta ose agresive, që të mos dëmtoni sipërfaqen.

Jeni të kujdesshëm që te pastrimi të evitoni tërë mbeturinat e lëndëve pastruese.

- **Brendësinë** e pastroni me ujë, të cilit i keni shtuar ca uthull të rralluar ose sodë ushqyese (1 lugë haje në 1 litër uji). Përfundimisht, me reckë të shtrydhur në ujin e pastër fshinja deri sa të teret.
- **Jashtësinë** e pastroni me reckë të butë dhe ca detergjent. Për pastrimin e **guarnicionit të kapakut** përdorni ujin me shkumë sapuni. Sipërfaqet e lustruara i pastroni me reckë të butë dhe lëndë pastruese në bazë të alkoolit (p.sh. lëndë pastruese për xhama). Mund të përdorni edhe alkool (etanol ose izopropilalkool). Për pjesët plastike dhe të lustruara nuk është i përshtatshëm përdorimi i lëndëve pastruese abrazive dhe special agresive, siç janë lëndët pastruese për teneqenë jokoroduese dhe të ngj.
- Nëqoftëse keni model të aparatit me kondensator të instaluar në anën e pasme të aparatit, kohë pas kohe (së paku një herë në vit) me fuqë të butë jometalike ose thithësin vakumor pastroni pluhurin nga kondensatori.


Nxjerrja e aparatit nga përdorimi

Nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza, zbrazni aparatën, shkrijeni dhe pastroni brendësinë. Në brendësi të aparatit vendoni kuti të hapur me sodë ushimi dhe lejeni kapakun gjysëm të hapur.


Evitimi i pengesave

Gjatë përdorimit të aparatit mund të paraqiten edhe pengesa në funksionim.

Cekim disa pengesa të cilat janë më së shpeshti pasojë e përdorimit joadekuat dhe mund t'i evitoni vetë.

Pengesa	Shkaku	Evitimi i pengesës
Pas kyçjes në rrjetën elektrike, aparatit nuk punon.	Në prizë nuk ka tension.	
	Aparati nuk është i kyçur. Pozicioni i pullës (A) te shenja  ka shkaktuar shkyçjen e arkës.	Aparati e kyçni me rrotullimin e termostatit (A) (shiqo kaptinën komandimi: kyçje, shkyçje). Rrotulloni pullën në drejtim të akrepit të orës ndërmjet të pjesës më të hollë dhe më të trashë të signacionit .

Pengesa	Shkaku	Evitimi i pengesës
Funksionimi i pandërprerë ose shumë i gjatë.	Kapaku ka qenë gjatë kohë i hapur.	
	Pulla e termostatit është e rregulluar në shumë ftohtë.	Rrotulloni pullën e termostatit A kah pjesa më e hollë e signacionit .
	Kondensatori nuk është i ftohur mjaftueshëm.	Kontrollojeni se a është mundësuar qarkullimi i papengueshëm i ajrit në anën e parë dhe të fundit. Evitoni pluhurin nga kondensatori (nëqoftëse keni model me kondensator të instaluar në murinë e fundit të aparatit).
	Pulla e termostatit është në pozicion për funksionim intensiv (ndriçon llambëza B).	
Arka dridhet, respektivisht punon me zë të lartë.	Pozicionimi i parregullt.	Siguroni dysheme adekuate.
	Arka preket me murinë ose elementet fqinje.	Largojeni arkën.
Në muritë e jashtme tubohet lagështi.	Hapësira e lagësht.	Me largimin nga muritë - dyshemeja, mundësoni qarkullim më të mirë të ajrit rreth aparatit.
	Dyshemeja dobët e izoluar.	
	Gjatë kohë nxehët dhe kohë e lagështë.	
Acari në brendësi të shkaktohet me tepërsi.	Arka ka qenë gjatë kohë ose shpesh herë e hapur.	
	Sasia tejet e madhe të artikujve ushqimorë të paftohtë mjaftueshëm.	
	Kapaku nuk mbyllet mirë.	Kontrolloni se a keni evituar distancuesit nga plastika dhe se qeskat të mos pengojnë mbylljen e kapakut.
Ndrriçon / rreh llambëza (D).	Aparati akoma nuk ka arrijtë temperaturën e rregulluar.	
	<ul style="list-style-type: none"> • Sasia tejet e madhe e artikujve ushqimorë të paftohur mjaftueshëm rrit temperaturën në brendësi. Llambëza do të shuhet pasi që ushqimi do të ftohet në temperaturën e rregulluar. • Gjatë kohë nuk ka pasë energji elektrike. • Hapja e shpeshtë e kapakut, respektivisht kapaku i hapur gjatë kohë. 	
Llambëza (B) nuk ndriçon megjithë funksionit SF të rregulluar.	Aparati ka arrijtë temperaturën SF të rregulluar.	

Pengesja	Shkaku	Evitimi i pengesës
Hapja e kapakut e vështirësuar:	Ventili për ajrosje në anën e pasme të aparatit është i shtupuar (e kanë vetëm disa modele).	Evitoni dhe pastroni ventilin siç shihet në fotos! 

Ndërrimi i llambës për ndriçimin e brendësisë së aparatit


Paraprkishtë se të ndërroni llambën, patjetër ndërpreni furnizimin me energji elektrike në aparat!

Me ndihmën e kaçavidhës zhvidhoni vidhën në kapakëzën prej plastike dhe e nxjerrni (shiqo fotosin).

Pastaj, llambën e djegur ndërroni me të re (E14, 15 W). Mos e hudhni llambën ndërmjet të mbeturinave organike.

Llamba është material shpenzues dhe garancioni për të nuk vlen.

Llambat që janë përdorur në këtë aparat, janë llamba të posaçme, të dedikuara vetëm për përdorim në aparatet e amvisërisë. Këto llamba nuk janë të përshtatshme për ndriçimin e hapësirave banesore ose në amvisëri.



MARRIM TË DREJTË PËR NDRYSHIME, TË CILAT NUK NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E APARATIT.

Udhëzimet për përdorimin e aparatit mund t'i gjeni edhe në WEB faqen tonë: www.gorenje.com / <http://www.gorenje.com> />

